



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7967/2022
Data: 20.09.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e tetë -VIII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.08.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrotje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergencë), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi i Mbledhje pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershori 2022.
3. Plani i integritetit për vitin 2022-2026.
4. Plani i punës së tri Komitetet Konsultative për vitin 2022.
5. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021-2022.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rrëth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershori 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni,

Zaim Bela thekson:- te drejtoria e shëndetësisë ishin përshirë disa donacione të cilat janë të muajit shtatë dhe përsëritet në gjashtë mujorin e dytë. A janë dhënë subvencionet për bujqit në gjashtë mujorin e parë apo vetëm subvencionet direkte nga Ministria e Bujqësisë.

Resul Suma thekson:- e përshëndes reportin gjashtë mujorë të ekzekutivit dhe është një raport shumë i mirë. Kërkoj sqarim për marrëveshjen për mbeturinat inerte për me mbushur guoren e Dimcës dhe për mbeturinat e ngurta

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i paketë mbeturinave të ngurta kemi bërë marrëveshje me kompaninë "Sharrcem" por e kanë ndërprerë për momentin për arsyen të tyre që potencojnë që nuk ka vend.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket donacioneve që u potencuan të muajit shtatë mendoj se është ndonjë gabim teknik.

Abduraman Bushi thekson:- subvencionet komunale ende nuk i kemi kryer se një herë janë shpall dhe njëri prej anëtarëve të komisionit ka qenë në pushim dhe në momentin që do të del në punë do t'i kryejmë procedurat.

Sherif Berisha thekson:- unë kam vërejtje ndaj ekzekutivit për arsyen të sjelljeve jo të mira me anëtarët e kuvendit të komunës për shkak se ne e kemi komitetit për politikë e financa dhe kuvendin e komunës ku mund të debatojmë. Është mirë që drejtorët të sillen mirë dhe më korrekt dhe të përgjigjen për ata që e kërkojnë anëtarët e kuvendit të komunës. Sa i përket raportit gjashtë mujori shkojë dhe ujë të pijes nuk kemi. Për çështjen e barnave të skaduara kërkoj që të na jepni një shpjegim se nga e kanë prejardhjen për të cilat kemi bërë kërkësë për me i asgjësuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket vërejtjes për drejtorët nuk e di konkret dhe te të ndryshmet mund ta diskutoni apo të paraqitni ndonjë vërejtje se për kënd e keni konkret fjalën por këtu bëhet fjalë për reportin gjashtë mujorë të punës. Sa i përket ujtit e kam sqaruar shumë herë se pse nuk ka ndodhur funksionalizimi i fabrikës që ka qenë neglizhenca te KEDS-i për shkak se ka kërkuar me i ndërruar disa shtylla për me bërë pranimin teknik të vendosjes së trafos dhe shtyllat nuk mundemi me i ndërruar se nuk kemi mjete financiare. Te barnat e skaduar besoj që është dashur me pasur informacion më të mirë se unë sepse drejtoresha e shëndetësisë ka qenë prej të njëjtë subjekt ku jeni ju por barnat e skaduar janë deponuar në mënyrë jo ligjore te qendra për shërbim të qytetarëve. Deri tash është bërë punë në selektimin e këtyre barnave, procedurat e udhëheqjes për asgjësimin e barnave me inspektoratin përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe është shpallur kompania fituese por është në fazën e ankesave. Ne po bisedojmë për reportin e punës dhe nuk jemi lëshuar në hulumtimin e këtyre barnave për prejardhje apo për ndonjë çështje tjetër.

Refet Kalisi thekson:-a do të mundemi me i realizuar projektet e hartuara. punimet që janë bërë te para objektit të postës janë bërë mirë por ka mbetur pak keq për njëzet metra katror para lokaleve afariste besoj që ka qenë mirë që edhe ajo pjesë të rregullohet. Për mbjelljen e drunjve dekorativ është mirë me pasur një vëmendje për shkak se është kohë e pa përshtatshme dhe minden me u tharë drunjët dhe pasi është bërë ajo puna është mirë me i mbikëqyrur.

Mehmet Ballazhi thekson:- me kapacitet që i kemi janë hartuar dhjetë projekte dhe disa janë donacione e disa me pagesë që i kemi bërë prej kodit ekonomik për hartim të projekteve. Nga marrja e detyrës problem kryesorë e kam pasur se nuk kam pasur asnjë projekt të hartuar në tavolinë përveç projektit të fabrikës së ujit dhe projektin e shtëpisë së kulturë që kanë qenë duke u kryer punimet. Projektet besoj që do të realizohen për shkak se kemi bërë projekte të realizueshme. Disa projekte ndoshta mund të duken të vogla por ne i kemi hartuar dhe do të kërkojmë donacione nga organizatat e ndërkombëtare. Projekti ka qenë për gjelbërimin e hapësirave për rrëth komunës dhe ne kemi shkuar edhe me një pjesë të gjelbërimit e cila nuk ka qenë në paramas por e kemi trajtuar. Pjesa e betonit që kanë lokalet përpëra është në shfrytëzim të tyre dhe nuk ka qenë në paramas. Mbjellja e drunjve dekorativ është dashur me përfunduar në muajin prill por me keqardhje po e them se kjo është bërë për shkak neglizhencës së zyrës së prokurimit që mendoj që është bërë qëllimi sht kjo neglizhencë dhe kanë ndodh në deri në këtë fazë por kemi kërkuar nga kompania që me pasur angazhim sa më të madhe për çështjen e drunjve dekorativ.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Plani i integritetit për vitin 2022-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:-ky planë është hartuar duke u mbështetur në strategjinë kundër korruptionit. OSB-ja na ka ndihmuar në hartimin e këtij plani të cilin e falënderojmë për angazhimin. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I INTEGRITETIT PËR VITIN 2022-2026

4. Plani i punës së tri Komitetet Konsultative për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SI TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2022

5. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni nodnjë propozim konkret mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- në disa departamente ka zbritje të taksave duke filluar prej qirasë, e te disa ka ngritje. Për kompaninë “Sharrcemi” ishte planifikuar të rritet taksa në 60 000 € ndërsa më poshtë është Terminali doganorë është propozuar që taksa të jetë 3000 €, që do të thotë se për kompaninë “Sharrcemi” është një ngritje prej 50 %. Ndërmarrje pyjore në Han të Elezit janë vetë dy dhe është mirë të shikohet se është propozuar 50 € për ndërmarrjet që merren me përpunimin e drurit, ndërsa për ndërmarrje pyjore 150 €. Është mirë me dhënë pak sqarime sa i përket taksave.

Mehmet Ballazhi thekson:- ne jemi në fazën e shqyrtimit të kësaj rregullore dhe kjo do të del edhe në debat publik . Sa i përket ngritjes dhe uljes së taksave ne e kemi propozuar por i vendos Kuvendi i Komunës dhe mospërputhje ndërmjet taksave nuk ka . Gjatë gjithë kohës eshtë diskutuar që kompania “Sharrcem” duhet të ndikon në përmirësimin e ambientit dhe ne kemi propozuar që me ja ngritur taksën dhe përmes asaj shume me realizuar ndonjë projekt që ka ndikim në ambient. Sa i përket uljes së taksës së Terminalit doganorë eshtë menduar në atë aspekt për shkak se nuk ka zhurmës dhe pluhur dhe ka qenë kërkesë e vetë pronarit . Sa i përket ndërmarrjeve pyjore mund të jepni propozime konkrete.

Sherif Berisha thekson:-terminali doganorë eshtë në procedura gjyqësore me komunën për shkak të mos pagesës së borxhit të cilën e kanë dërguar po kërkohet me ja zbritur taksën por ne do t'i japim propozimet tona por eshtë mirë me qëndruar aty ku eshtë . Si do të vepron komuna me kabllo të cilat janë të vendosura nëpër shtyllat e KEDS-it apo do të shkon sikur në avazin e vjetër që nuk ka përfituar komuna asgjë.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket aspektit gjyqësorë secili e kemi punën e vetë dhe ata e kanë punën me çështjen e gjykatave dhe e kanë drejtën e vetë për me parashtruar ankesë . Si ekzekutiv i kemi parashtruar propozimet e tona dhe tash jemi në fazën që kuvendi mund të parashtron propozime dhe ato propozime përcillen edhe në debat publik dhe pas debatit publik përcillen për miratim në kuvend. Sa i përket kabllove do të mundohemi me realizuar objektivat tona duke u bazuar në bazë të ligjeve në fuqi dhe tarifa e kabllove eshtë edhe më herët por pse nuk e kanë zbatuar eshtë çështje tjerë që ndoshta dikush mund të kërkon llogari se pse nuk eshtë zbatuar.

Hyriete Isufi thekson:- kërkoj sqarim te pika 5 dhe 5.5 lartësia e taksës për përdorim të brendshëm dhe lartësia e taksës për përdorim të jashtëm.

Natyra Kalisi thekson:- në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme 01/2022 dokumentet e gjendjes civile për përdorim brenda Kosovës dhe atë dokumentet për regjistrim të nxënësit mund të dokumentohen me një letër të thjeshtë , ndërsa për ambasada për shtete të huaja lëshohen me dokument të agjensionit civil . për deri sa eshtë në letër të thjeshtë kemi propozuar që me i ulur taksat për këto dokumente të cilat janë të parashtruara.

Resul Suma thekson:- propozoj që jetë edhe taksa nënshkruese për personat të cilët i dëmtojnë shtyllat e ndriçimit. Eshtë mirë që eshtë propozuar ulja e taksës për lokalet e vogla.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzéri.

U VOTUA RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021-2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:-materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni nodnjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- në të gjitha shkollat a ka nxënës të cilët e kanë përsëritur vitin apo shkollat.

Hisni Luri thekson:-në tabelë janë shënuar se 51 të cilët e kanë përsëritur vitin.

Nora Xhoni thekson:- sa eshtë numri i nxënësve të cilët janë larguar nga Hani i Elezit

Hisni Luri thekson:- janë 39 nxënës të çregjistruar dhe nëse shkohet me këtë avaz me të cilin kanë filluar me u larguar qytetarët atëherë i bien që duhet të ulet edhe numri i mësimdhënësve pér shkak se nga niveli qendrorë buxheti ndahet në bazë të numrit të nxënësve.

Sherif Berisha thekson:- a janë bërë përgatitjet nëpër shkolla pér fillimin e vitit të ri shkollorë. Ka informacione se është mbyllur paralelja shkollore në fshatin Krivenik.

Hisni Luri thekson:- si drejtori i kemi bërë të gjitha përgatitjet pér fillimin e procesit mësimorë. Do të mbyllët paralelja shkollore në fshatin Krivenik dhe fëmijët do të barten në shkollën më të afërt pér shkak se nuk ka asnjë kusht elementarë pér me pasur proces mësimorë aty, këta që janë asamblistë dhe janë mësimdhënës e dinë çka është mësimi i kombinuar por aty as mësim të kombinuar nuk ka. Në publik ndoshta tingëllon si keq mbyllja e paraleles shkollore në fshatin Krivenik por nuk jemi që po duam me mbyllur por po i hapim sytë pér shkak se çdo herë që kanë ardhur nxënësit nga një fshat i tillë kanë ardhur me sukses shumë të dobët.

Resul Suma thekson:- a është kryer çështja e psikologut se po flitet që në këtë vit do të fillon punën edhe psikologu sepse mos të na ndodhë sikur rasti makabër në Prishtinë .

Hisni Luri thekson:-kërkesë kemi parashtruar në kompaninë “Sharrcem” por po insistojmë që ta rekrutojmë përmes Ministrisë së Arsimit të cilën e kemi pozitive por konkretisht nuk kemi diçka , ndërsa nga kompania “Sharrcem” e kemi pozitive kërkesën dhe po mbetemi ta rekrutojmë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim pér këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Informatë pér korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- pér këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Zaim Bela thekson:- në raport shënon se janë mbjell dymbëdhjetë hektarë dhe rendimenti është shumë i ulët por duke e parë krizën që është bërë është mirë me i nxituar bujqit që me i mbjell pronat edhe pse çdo herë kombaji ka qenë problem . Bujqve duhet të ju ipet subvencione që t'i mbjellin arat me grurë.

Abduraman Bushi thekson:- pér këtë vit nuk kam mundësi me dhënë subvencione pér legjislacionit që e parashoh sepse brenda një vitit nuk mundemi me subvencionuar një kulturë dy herë, ndërsa pér vitin e ardhëshm do t'i shikojmë mundësitë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim pér këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- pér këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- sa është e lejuar me rregullore me u bërë ndërtimi me kate ka pjesa e z.Hebib Dernjanit . Kërkoj të më jepet me shkrim leja me që ja keni dhënë personit në fjalë pronarit të kompanisë “Elektra”. Ushtruesja e detyrës si drejtoresh e QKMF-së sipas informacioneve që kam vendimin e ka pasur deri me datë 30.07.2022 , a ju është vazhduar me vendim apo do të shpallet konkurs. Në mars të viti 2021 pér herë të parë në QKMF konkretisht në sektorin laboratorit kanë filluar të bëhen disa analiza CRP-ja, T3, T4,TSH, KBA, sheqeri tre mujorë dhe desha të dijë se a po kryhen tanë këto analiza apo janë bartur ka kufiri apo në ABC . Certifikatat shëndetësore më herët janë lëshuar në komunën tonë dhe tash po duhet me shkuan dhe me i marr në Kaçanik. kur mendohet me i dhënë këto certifikata në QKMF.

Resul Suma thekson:- një shumicë e popullatës së Hanit të Elezit është tu migruar në komuna të tjera kemi mundësi për me ndërruar ligjin për etazheterë dhe për me thithë ndonjë donatorë . Problemi me procedura ka shkuar shumë gjatë dhe a ka mundësi me bërë një marrëveshje për me i lejuar investitorët për shkak se pse një familje prej Hanit të Elezit me shkuar dhe me banuar në Ferizaj kur i ka të gjitha kushtet këtu. A kemi mundësi me i ndryshuar uniformat e nxënësve. Punëtorët e NPL pastrimi gjatë sezonës së verës i kryejnë punimet nga ora 22:00 dhe ata kanë nevojë për me pushuar dhe propozoj që të ju bëhet puna prej mëngjesit me filluar. Në sezonin e dimrit kemi me pasur redukttime të rrymës elektrike dhe është mirë që me bërë që një shtyllë me pasur rrymë dhe një shtyllë jo në mënyrë që me kursyer rrymën.

Refet Kalisi thekson:- agregati i cili është vendosur te çerdhja a është i kyçur në rrymë për shkak se tash ka ndërprerje të rrymës. Dy karrika janë marr nga parku dhe janë dërguar te posta dhe është mirë me i blerë dhe me i vendos te posta dhe ulëset me u kthyer te parku. Pse janë ndërprerë punimet te realizimi i projektit parku i qytetit. Te ndriçimi publik shumë drita janë bërë për me u ndërruar dhe është mirë me kontaktuar me kompaninë për këtë çështje.

Xhevahir Dernjani thekson:- tash fillon muaji shtatorë dhe është mirë të bëhet përgatitja e lëndëve djegëse nëpër shkolla në mënyrë që mos me na ndodhur sikur në vitin 2021 që me i marr drutë nga QKMF-ja dhe me i dërguar në Paldenicë.

Zaim Bela thekson:- sektori i gjendjes civile ka punuar edhe gjatë pauzës edhe ditëve të shtunë por a keni ndonjë raport se sa individë kanë kërkuar me u pajisur me dokumentacione në këto orare që i keni përcaktuar me punuar.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket etazhitetit të ndërtesave është punë e ndërlikuar për shkak se janë në pyetje normat teknike të ndërtimit, planet rregulluese urbane. Jemi në fazën e hartimit të hartës zonale të komunës që është një lloj plani urbanistik të cilin e kemi diskutuar me ekspertë e që në asnjë mënyrë nuk kanë lëshuar pejë me rritur etazhitetin për shkak se janë udhëzimet administrative të cilat e përcaktojnë . Ne do të bisedojmë edhe me Ministrinë e Planifikimit Hapësinorë për çështjen e etazhitetit për shkak se në Han të Elezit kemi probleme shumë të madh sa i përket ndërtimit duke filluar nga ndërtesat e vjetra të cilat janë në gjendje të mjerueshme. Kompania i ka ndërprerë punimet për momentin dhe sot ka kërkuar një matje gjeodezike për nivelimin e tokës dhe besoj që shumë shpejtë do të fillojnë punimet . Kompania e ka me kontratë dinamikën për me i kryer punimet. Sa i përket ulëseve te parku ka me i rregulluar, ndërsa këto tjerat i kam vendosur unë këtu.

Hisni Luri thekson:- çështjen e uniformave e kemi diskutuar me drejtorët edhe për nxënësit edhe për stafin mësimorë dhe e kemi në listë të projekteve por jemi duke menduar që me kryer këtë projekt në formë të një donacionit. Fillimisht kemi menduar që uniformat të ndryshohen në shkollë të mesme që të bëhet një model shumë i mirë. Sa i përket gjeneratorit te çerdhja dy herë kemi tentuar me lidhur por nuk e kemi lidh për shkak se një herë është ndërtuar baza tash e kemi një pjesë me rrëthuar dhe me mbyllur që me ja hequr atë vrazhdësinë e aggregatit. Kur kemi dashur me lidhur kanë potencuar se është shumë afër çerdhes , pastaj potencuan që është largësi pak e madhe dhe fillon me humbur energjinë . Gjeneratori nuk ka qenë në rregull dhe është dashur me rregulluar. Sa i përket lëndëve djegëse i kemi zhvilluar procedurat dy muaj më herët si procedura.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- ushtrueses së detyrës në QKMF ja kemi vazhduar detyrën për shkak se procesi për rekrutim të drejtorit zgjatë kogja shumë dhe nuk guxojmë ta lëmë QKMF pa menaxher. Analizat të cilat u potencua të gjitha kryhen në QKMF mirëpo në momentet që shpenzohen materialet shpenzuese të laboratorit duhet të zhvillohen procedurat përmes prokurimit dhe deri sa të kryhet procedurat pacientët shkojnë nëpër laboratore private. Certifikatat e shëndetësisë lëshohen nga specialistë të mjekësisë familjare dhe e kemi në mungesë

Natyra Kalisi thekson:- interesim ka pasur nga qytetarët edhe gjatë pauzës edhe gjatë ditës së shtunë për me u pajisur me dokumente të gjendjes civile.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e mbeturinave e kemi diskutuar me drejtorin e kompanisë dhe kërkesë e imja ka qenë që në mbrëmje me i bartur mbeturinat për shkak se kontinjerët i qesin natën dhe është problem prej qenve endacak . Çështja e orarit është çështje e brendshme e kompanisë por neve si komuna na intereson që ambientin me mbajtur të pastër.

Arsim Dernjani thekson:- për çështje të ndriçimit publik në mëngjes kisha një takim me z.Hebib Dernjani dhe besoj që do të bëhet zgjidhje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:23

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi Kuvendit
Florim Shkreta